

VENDIM
Nr. 420, datë 27.6.2012

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, CIKLI I PARË I STUDIMEVE
ME KOHË TË PLOTË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE
TË CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013**

(Ndryshuar me vendimin nr. 710, datë 24.10.2012; nr 123, datë 30.1.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2012-2013, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë 27 647, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, si dhe për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë | 27 047; |
| b) Kuota për program të dytë studimi | 200; |
| c) Kuota për transferim studimesh | 300; |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj | 100. |

2. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë përbëhet nga:

- | | |
|--|---------|
| a) Kuotat e pranimi për kandidatët brenda territorit të vendit | 26 307; |
| b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit | 700; |
| c) Kuotat për të verbrit (të veçanta) | 20; |
| ç) Kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët | 20. |

3. Kuotat e pranimi në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimi për programet e studimit të ciklit të parë, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë, të trojeve jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc e Medvegje dhe pasqyrohen në tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së

Shqipërisë, sipas propozimeve nga ministrinë e arsimit dhe autoritetet përgjegjëse respektive.

Në bazë të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, kandidatët nga Republika e Kosovës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në programe të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë. E njëjta procedurë ndiqet edhe për kandidatët nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Kriteret e vlerësimit dhe të pranimi të tyre në këto programe studimi përcaktohen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë dhe bëhen të njohura në median e shkruar e elektronike për të gjithë kandidatët e interesuar.

5. Kuotat e pranimi për të verbrit, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen për kandidatët më statusin e të verbrit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas propozimit të Shoqatës Kombëtare të të Verbërve.

6. Kuotat e pranimi për romët dhe ballkano-egjiptianët, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas propozimeve të Shoqatës Kombëtare të Romëve dhe asaj të ballkano-egjiptianëve.

7. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga persona të interesuar.

8. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vitin akademik 2012-2013, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. *Kandidatët që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin e ri akademik 2012-2013, si dhe studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve dhe që vijnë nga këto shtesa sociale, si: personat që nuk shikojnë/personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentët, të cilëve njëri nga prindërit u është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore si “familje në nevojë”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie, fëmijët e policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.*

10. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet.

11. *Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në vitin akademik 2012-2013, 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimi (pikët e situara në sistemin meritë-preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Përjashtim bëjnë Universiteti i Arteve dhe Akademia e Arteve Shkodër, në të cilat 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimi (pikët e situara në sistemin meritë-preferencë) në nivel fakulteti, nuk paguajnë tarifën vjetore të shkollimit.*

12. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, si edhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, mbështetur dhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

13. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të

përcaktuara në aktet nënligjore dhe në statutin e rregulloret e tyre.

14. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë, në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

15. Kandidatët, që kanë përfunduar me sukses provimet e detyruara dhe ato me zgjedhje të “Maturës Shtetërore”, si dhe programin e parë të studimeve me rezultate të shkëlqyera, gëzojnë të drejtën të vijojnë studimet në një program të dytë studimi, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi.

16. Kandidatët, që kërkojnë të studiojnë në program të dytë studimi në Universitetin e Arteve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në programin e studimit të ciklit të parë “Edukim fizik dhe sporte” të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, e të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Akademinë e Arteve të Shkodrës, si dhe në programet e studimit “Arkitekturë (Arkitekt)” dhe “Arkitekturë (Urbanist)” të Universitetit Politeknik të Tiranës, përveç përcaktimeve të pikës 15 të këtij vendimi, duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta (përfshirë këtu konkurset e pranimit), të vendosura nga vetë këto institucione të arsimit të lartë.

17. Studentët, që vijojnë një program të dytë studimi, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të njëjtë me koston e plotë të studimeve, të përcaktuar në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

18. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare shtetërore janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

19. Pranimi i studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nëpërmjet parimit meritë-preferencë dhe kryhet në dy raunde (me dy formularët A2 dhe A3).

19.1 Shpërndarja e fituesve në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u mbështetur në rezultatet e shkollës së mesme, të Maturës Shtetërore (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2) zhvillohet në dy faza: regjistrimi on line dhe dorëzimi i dokumentacionit shtesë pranë institucioneve të arsimit të lartë publik ku janë shpallur fitues.

19.2 Kuotat që mbeten të parealizuarra për çdo program studimi pas aplikimit me formularin A2, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të propozimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë.

19.2.1 Në raundin e dytë kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë maturanët/kandidatët, që kanë konkurruar në raundin e parë me të njëjtën renditje preferencash të atij raundi, me përjashtim të:

- a) fituesve të preferencës së parë, të cilët janë regjistruar në këtë program studimi;*
- b) maturanëve/kandidatëve, të cilët nuk kanë kërkuar vazhdimin e konkurrimit për preferenca më të larta gjatë regjistrimit on line dhe që rezultojnë të regjistruar në programin e studimit të preferuar.*

19.2.2 Formulari A3 përfshin programet e studimit të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë me kuotat respektive të shpërndara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët:

- a) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;*
- b) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e vjeshtës 2012;*
- c) kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë Republikës së Shqipërisë dhe u janë ekuivalentuar rezultatet e shkollës së mesme dhe provimet e Maturës Shtetërore;*

ç) kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë (të vjeshtës) dhe rezultojnë kalues në provimet me zgjedhje.
19.2.3 Kuotat që mbeten të parealizhuara edhe pas regjistrimit të fituesve të shpallur nga aplikimi në raundin e fundit, nuk rishpallen.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha